

**LIGJ Nr. 126/2016 date 15.12.2016**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 61/2012, “PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

**Ligj nr. 126/2016 date 15.12.2016, Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 61/2012, Per akcizat ne republiken e shqiperise, te ndryshuar**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 84, pika 4, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 14, pika 1, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në shkronjën “d”, pas përcaktimit “me faturë TVSH-je dhe sipas” shtohet përcaktimi “masës, kritereve”.

b) Shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë:

“dh) për biokarburantet që përdoren në sektorin e transportit dhe mishelohen në territorin e Republikës së Shqipërisë për vlerën e detyrimit të akcizës së paguar që i korrespondon masës së produktit “BIO” që gjendet në produktin e deklaruar për konsum pas konfirmimit nga laboratorit kimik doganor dhe pas verifikimit prej autoritetit doganor, deri në masën 5%. Procedurat dhe kriteret për rimbursim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Rimbursimi për sasinë e biokarburanteve kryhet deri në vitin 2020.”.

**Neni 2**

Në nenin 41, pikat 7 dhe 8, kudo në përmbajtje, pas fjalëve “magazinë fiskale stokimi” shtohen fjalët “ose magazinë doganore, sipas përcaktimeve në Kodin Doganor”.

**Neni 3**

Në nenin 51, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“ 3. Produktet energjetike që klasifikohen në grupin E500 me kodet e NK 27 11 i nënshtrohen pagesës së akcizës, sipas shtojcës nr. 1 të këtij ligji, vetëm nëse këto produkte

janë për përdorim si lëndë djegëse për automjetet në transportin rrugor. Procedura e aplikimit të kësaj dispozite përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

#### Neni 4

Në nenin 86, pika 2, pas fjalës “lëvizjes” shtohen fjalët “nën pezullim të detyrimeve të akcizës”.

#### Neni 5

Neni 87 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 87

### **Shmangia nga verifikimi ose pagimi i akcizës**

1. Pa rënë ndesh me Kodin Penal, kryen kundërvajtje administrative në fushën e akcizës kushdo që:

a) shmang, me çfarëdolloj mjeti apo mënyre, produktet e akcizës nga verifikimi dhe/ose nga pagimi i akcizës;

b) u jep operatorëve, që u nënshtrohen detyrimeve të akcizës, produkte të përjashtuara nga akciza ose me akcizë të reduktuar;

c) kryen operacione përzierjeje të paautorizuara të produkteve të akcizës, prej të cilave përfitohet një produkt që i nënshtrohet një akcize më të lartë, krahasuar me akcizën e secilit komponent veçmas;

ç) rigjeneron produkte të denatyrura, me qëllim përdorimin abuziv të tyre dhe shmangien e pagesës së detyrimit të akcizës;

d) mban produkte akcize të denatyrura në kushte të ndryshme nga ato të përcaktuara për të pasur një trajtim të diferencuar;

dh) mban ose përdor produkte të përfutuara nga fabrikimi klandestin apo nga përzierje të paautorizuara;

e) mban, tregton ose përdor produkte të denatyrura, të përziera me produkte që i nënshtrohen pagesës së akcizës;

ë) përdor, përzien, shet produkte akcize me përjashtim apo reduktim, për qëllime të ndryshme përdorimi nga ai për të cilin kanë përfituar përjashtim apo reduktim;

f) tregton produkte që i nënshtrohen akcizës, pa dokumentacion fiskal.

2. Shkeljet e referuara në pikën 1, të këtij neni, dënohen:

a) për herën e parë të konstatuar, me gjobë sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar;

b) për herën e dytë të konstatuar, me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar;

c) për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar dhe revokim i autorizimit për një periudhë dyvjeçare.

Përveç gjobës që zbatohet, mallrat e akcizës të gjetura pa dokumentacion fiskal sekuestrohen. Mallrat çlirohen nga sekuestroja nëse brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit paguhet i gjithë detyrimi dhe sanksioni përkatës. Nëse nuk plotësohen këto kushte, mallrat konfiskohen dhe administrohen në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative për të mbuluar detyrimin dhe sanksionin e vendosur ose në pamundësi shkatërrohen. Nëse nga shitja gjenerohen të ardhura, të cilat kalojnë shumën e detyrimit dhe gjobës, teprica shkon në Buxhetin e Shtetit.

3. Gjoha për shkeljet e parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni, llogaritet

jo vetëm për produktet tërësisht të përfunduara, por edhe për ato që mund të përftoheshin nga lëndët e para gjatë përpunimit ose në pritje për t'u përpunuar apo që gjenden në fabrikë ose në ambientet ku është kryer shkelja.

4. Gjoha për shkeljet e parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, llogaritet jo vetëm për produktet që janë duke u rigjeneruar ose tërësisht të rigjeneruara, por edhe për produktet e denaturuara, që gjenden në ambientet ku është kryer shkelja.

5. Depozituesit të miratuar, i cili ka kryer për herë të tretë shkeljen e parashikuar në shkronjat “e” dhe “ë”, të pikës 1, të këtij neni, i hiqet për dy vjet e drejta për të përfituar nga përjashtimet.”.

Neni 6

Neni 88 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 88

### **Prodhimi klandestin i produkteve të akcizës**

1. Pa rënë ndesh me Kodin Penal, kushdo, që prodhon në mënyrë të padeklaruar dhe të paautorizuar (klandestine) nga autoritetet doganore produkte që i nënshtrohen pagesës së akcizës, dënohet me:

a) gjobë sa 5-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar për këto produkte të akcizës, të prodhuara në mënyrë të padeklaruar dhe të paautorizuar (klandestine). Gjoha, përveç produkteve tërësisht të përfunduara, aplikohet edhe për produktet që mund të përftoheshin nga lëndët e para në përpunim ose në pritje për t'u përpunuar apo që gjenden në mjediset, në fabrikë a në lokalet ku është kryer shkelja;

b) sekuestrim të makinerive, pajisjeve, mjeteve ndihmëse të prodhimit, lëndës së parë, çdo materiali të nevojshëm për prodhimin e këtyre produkteve, si dhe të gjitha produktet e akcizës të gjetura në çdo kohë.

2. Në kuptim të pikës 1, të këtij neni, me prodhim të paautorizuar kuptohet prodhimi i produkteve të akcizës që kryhet në ambiente dhe me pajisje të padeklaruar dhe të pakontrolluara paraprakisht ose të ndërtruara apo të modifikuara, në mënyrë që produkti të shmanget nga verifikimi.

3. Prodhimi i paautorizuar provohet me praninë në të njëjtin ambient ose në ambientet ngjitur të lëndëve të para të nevojshme për përgatitjen e produkteve të akcizës dhe linjave të prodhimit, të nevojshme për prodhimin e produkteve të akcizës.

4. Mallrat çlirohen nga sekuestroja nëse brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit paguhet i gjithë detyrimi dhe sanksioni përkatës. Nëse nuk plotësohen këto kushte, mallrat konfiskohen dhe administrohen përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative për të mbuluar detyrimin dhe sanksionin e vendosur ose në pamundësi shkatërrohen. Nëse nga shitja gjenerohen të ardhura, të cilat kalojnë shumën e detyrimit dhe gjobës, teprica kalon në Buxhetin e Shtetit.”.

Neni 7

Neni 88/1 shfuqizohet.

Neni 8

Neni 89 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 89

## Manipulimi i pajisjeve dhe shenjave

1. Pa rënë ndesh me Kodin Penal, kryen kundërvajtje administrative kushdo që shmang produktin nga verifikimi:

a) duke hequr, prishur, manipuluar ose bërë të palexueshëm matësit, plumbçet, pullat, markuesit, ngjyruesit, vulat, treguesit e verifikimit ose pajisje të tjera të nevojshme, të kërkuara apo të vendosura nga autoritetet doganore për qëllime verifikimi dhe kontrolli, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

b) duke mbajtur apo përdorur plumbçet, vulat, pullat, markues, ngjyrues, treguesit e verifikimit ose shenja të tjera të manipuluar ose pa autorizim, të cilat përdoren për qëllime verifikimi dhe kontrolli nga autoritetet doganore, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Shkeljet e referuara në pikën 1, të këtij neni, dënohen si më poshtë:

a) për herën e parë të konstatuar, me gjobë sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës të shmangura të produkteve të akcizës, të konvertuara në sasi të përkatëse sipas parashikimeve të këtij ligji;

b) për herën e dytë të konstatuar, me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës të shmangura të produkteve të akcizës, të konvertuara në sasi të përkatëse, sipas parashikimeve të këtij ligji;

c) për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës të shmangura të produkteve të akcizës, të konvertuara në sasi të përkatëse sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. Pavarësisht nëse është përfshirë ose jo në shkeljet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, depozituesi i miratuar, i cili ka për detyrë të marrë masat e duhura për ruajtjen dhe mirëfunksionimin e matësve, pajisjeve pullave dhe shenjave të tjera të sipërpërmendura, dënohet me gjobë 500 000 lekë.”.

Neni 9

Nenet 89/1 dhe 89/2 shfuqizohen.

Neni 10

Neni 90 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 90

### **Teprica ose mangësi në magazinën fiskale dhe në qarkullimin e produkteve që i nënshtrohen akcizës**

1. Mangësitë mbi 2 për qind, përveç firove të lejuara, krahasuar me regjistrat kontabël, të konstatuara në magazinat fiskale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në masën sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës të munguara që duheshin paguar.

2. Në rastin e produkteve të denatruara, kur mangësitë e konstatuara janë mbi 1 për qind deri në 2 për qind, përveç firove të lejuara, krahasuar me regjistrat kontabël, përveç pagesës së akcizës me tarifën më të lartë të këtij produkti, aplikohet gjobë në masën 200 000 lekë.

3. Në rastin e produkteve të denatruara, kur mangësitë e konstatuara janë mbi 2 për qind, përveç firove të lejuara, krahasuar me regjistrat kontabël, aplikohet gjobë në masën sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës me tarifën më të lartë që duhej paguar, por jo më pak se 200 000 lekë.

4. Nëse konstatohen sasi tepër, krahasuar me regjistrat kontabël dhe nëse sasia tepër nuk kalon 2 për qind të sasisë së raportuar, depozituesi i miratuar gjobitet me 200 000 lekë. Sasia

tepër pasqyrohet në regjistrat kontabël.

5. Për teprica në magazinat fiskale, si dhe teprica të produkteve të denatyruara, mbi 2 për qind dhe të pajustificuara në dokumentacionin përkatës, aplikohet:

a) për herën e parë të konstatuar, gjobë sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, por jo më pak se 200 000 lekë;

b) për herën e dytë të konstatuar, me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, por jo më pak se 200 000 lekë;

c) për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, por jo më pak se 200 000 lekë.

Sasia tepër pasqyrohet në regjistrat kontabël.

6. Për mangësi mbi firot e lejueshme, të konstatuara në mbërritjen e produkteve që transportohen në regjim pezullues, aplikohet një gjobë sa njëfishi i shumës së detyrimit të akcizës që duhej paguar të sasisë mangët. Nëse mangësia, përveç firove të lejuara, është mbi 2 për qind e sasisë totale të produkteve të akcizës, aplikohet gjobë:

a) për herën e parë të konstatuar, sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar;

b) për herën e dytë të konstatuar, gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar;

c) për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar për tentative për të shmangur produktin nga pagesa e akcizës.

7. Depozituesi i miratuar, të cilit i gjenden produkte akcize ose lëndë të para të paautorizuara, dënohet:

a) për herën e parë të konstatuar, me gjobë sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar për këto mallra akcize të paautorizuara;

b) për herën e dytë të konstatuar, me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar për këto mallra akcize të paautorizuara;

c) për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar për këto mallra akcize të paautorizuara.

Gjoha, përveç produkteve tërësisht të përfunduara, aplikohet edhe për produktet e akcizës që mund të përftoheshin nga lëndët e para të paautorizuara, në përpunim ose në pritje për t'u përpunuar, që gjenden në ambientet e magazinës fiskale.

8. Për diferenca të konstatuara në cilësi ose në sasi të produkteve të destinuara për eksport, që i nënshtrohen akcizës dhe atyre të deklaruara për t'u përjashtuar ose për t'u rimbursuar, aplikohet gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar.

9. Për diferenca të konstatuara në cilësi të produkteve që i nënshtrohen akcizës, aplikohet gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar.

10. Tepricat ose mangësitë në pulla fiskale, të konstatuara gjatë kontrollit të magazinave fiskale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen si diferencat në produkte akcize të konvertuara në sasi të përkatëse, sipas parashikimeve të këtij ligji.

11. Për efekt të përlogaritjes së masës së detyrimeve të akcizës për mangësitë apo tepricat në magazinat e prodhim/stokimit të lëndëve të para për prodhimin e produkteve të akcizës, niveli i akcizës do të llogaritet në masën e produktit me taksimin më të lartë që mund të prodhohet me këto lëndë të para.

12. Në rastet kur lëndët e para janë të garantuara, përlogaritja e detyrimeve të akcizës bëhet sipas shkallës së taksimit, mbi të cilën është llogaritur garancia e tyre.”.

Neni 11

Neni 91 shfuqizohet.

Neni 12

Në nenin 91/1, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Për teprica në mjediset e pritësit të regjistruar mbi 2 për qind dhe të pajustificuara në dokumentacionin përkatës aplikohet:

a) për herën e parë të konstatuar, gjobë sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, por në çdo rast jo më pak se 50 000 lekë;

b) për herën e dytë të konstatuar, gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, por në çdo rast jo më pak se 50 000 lekë;

c) për herën e tretë të konstatuar e më pas, gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, por në çdo rast jo më pak se 50 000 lekë.

Sasia tepër pasqyrohet në regjistrat kontabël.”.

#### Neni 13

Në nenin 94 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1, shkronja “a”, dhe në pikën 2, përcaktimi “detyrime fiskale” zëvendësohet me përcaktimin “detyrime të akcizës”.

2. Në pikën 1, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) Kur shkelja konstatohet gjatë transportit, mjeti i transportit në të cilin gjenden mallrat në fjalë sekuestrohet. Mjeti i transportit çlirohet nga sekuestroja nëse brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit paguhet i gjithë detyrimi dhe sanksioni përkatës. Nëse nuk plotësohen këto kushte, mjeti i transportit konfiskohet dhe shitet, në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative, për të mbuluar detyrimin dhe sanksionin e vendosur.

Mjetet e transportit përjashtohen nga sekuestrimi ose sekuestrimi i vendosur revokohet apo anulohet kur, në bazë të provave që disponohen, rezulton se pronari i tyre nuk është i përfshirë në shkeljen në fjalë. Nëse nga shitja gjenerohen të ardhura, të cilat kalojnë shumën e detyrimit dhe gjobës, teprica kalon në Buxhetin e Shtetit.”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Mallrat e konfiskuara trajtohen në përputhje me ligjin “Për kundërvajtjet administrative”, ose në pamundësi shkatërrohen.”.

#### Neni 14

Neni 95 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 95

### **Mbajtja, transportimi ose shitja e produkteve të akcizës pa shenjues ose ngjyruës**

Mbajtja, hedhja në qarkullim të lirë, tregtimi, eksportimi, importimi, shpërndarja, transportimi, rafinimi ose kryerja e çdo aktiviteti tjetër me produktet që markohen/shenjohen apo ngjyrosen apo që nuk kanë markuesin/shenjuesin apo ngjyruës në sasinë dhe përqendrimin e duhur dënohen si më poshtë:

a) për herën e parë të konstatuar, me gjobësa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duhet të paguhet për të gjithë sasinë e produktit të gjendur në depozitë, për herën e dytë të konstatuar me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duhet të paguhet për të gjithë sasinë e produktit të gjendur në depozitë dhe për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobësa 5-fishi i detyrimeve fiskale që duhet të paguhet për të gjithë sasinë e produktit të gjendur në depozitë;

b) me sekuestrimin e të gjithë sasisë së produktit të gjendur në depozitë dhe të mjetit të transportit, kur shkelja është verifikuar gjatë këtij procesi. Mjetet e transportit përjashtohen nga sekuestrimi ose sekuestrimi i vendosur revokohet ose anulohet kur, në bazë të provave që

disponohen, rezulton se pronari i tyre nuk është pëfshirë në shkeljen në fjalë.

Mallrat dhe mjete i transportit të sekuestruara çlirohen nëse paguhet i gjithë detyrimi dhe sanksioni përkatës dhe më pas mallrat shenjohen ose ngjyrosen në mënyrën e duhur. Nëse nuk plotësohen të gjitha këto kushte, këto mallra dhe mjete konfiskohen dhe shiten në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative, për të mbuluar detyrimin dhe sanksionin e vendosur ose shkatërrohen në rastet kur nuk plotësojnë standardet për të qarkulluar në Republikën e Shqipërisë. Nëse nga shitja gjenerohen të ardhura, të cilat kalojnë shumën e detyrimit dhe gjobës, teprica shkon në Buxhetin e Shtetit.”.

#### Neni 15

Nenet 95/1 dhe 95/2 shfuqizohen.

#### Neni 16

Në nenin 96 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në paragrafin e parë, termi “fiskale” zëvendësohet me termin “të akcizës”.

2. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Për efekt të përlllogaritjes së masës së detyrimeve të akcizës për mangësitë apo tepricat në magazinat e prodhim/stokimit të lëndëve të para për prodhimin e produkteve të akcizës, niveli i akcizës do të llogaritet në masën e produktit me taksimin më të lartë që mund të prodhohet me këto lëndë të para.

Në rastet kur lëndët e para janë të garantuara, përlllogaritja e detyrimeve të akcizës bëhet sipas shkallës së taksimit mbi të cilën është llogaritur garancia e tyre.”.

#### Neni 17

Neni 96/1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 96/1

#### **Raste të tjera**

1. Shkeljet, të cilave u referohet shkronja “a”, e pikës 1, të nenit 85, të parashikuara shprehimisht në këtë kre, të cilat nuk kanë sjellë mospagim të detyrimeve që duheshin paguar, dënohen me gjobë 50 000 lekë.

2. Kur i njëjti person ka kryer disa kundërvajtje administrative në të njëjtën kohë, çdo shkelje ndëshkohet në veçanti.

3. Shkelja e mbetur në tentativë ndëshkohet si shkelje e kryer.”.

#### Neni 18

Shtojca 1, që i bashkëlidhet ligjit në fuqi, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij ligji.

#### Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2017.

K R Y E T A R I

**Ilir META**

Miratur në datën 15.12.2016



**SHTOJCA NR. 1**

**MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

<b>Kategoria</b>	<b>Kodi NK</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Shkalla taksimit</b>
<b>I</b>		<b>KAFE</b>	
C100 Kafe e papjekur	09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	0
C200 Kafe e Pjekur	09 01 21 00 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	60 lekë/kg
C300 Lëkura, lëvoret zëvendësuesit e kafesë	09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë. Zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe	50 lekë/kg
C900 Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre	21 01 11 00 21 01 12 92 21 01 12 98	Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafe etj.)	250 lekë/kg kafe
<b>I/1</b>		<b>PIJE ENERGJIKE</b>	
D000	22 02 10 00	Pije energjike	30 lekë/litër
<b>II</b>		<b>BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE</b>	
B000 Birra	22 03	Birrë e bërë nga malto: -nga prodhues vendas e të huaj, ligjërisht dhe ekonomikisht te pavarur, me sasi më të vogël se 200 000 HL në vit:  Nga prodhues vendas e të huaj, ligjërisht dhe ekonomikisht te pavarur, me sasi më të madhe se 200 000 HL në vit	360 lekë/HL/ shkallë alkoolometrike  710 lekë/HL/ shkallë alkoolometrike
W200 Vera e qetë dhe pijet e qeta të fermentuara	22 04 21 22 04 29 22 04 30 22 04 30 10 22 04 30 96 22 04 30 98 22 05 10 10 22 05 90 10 22 06 00 10	Verë e qetë dhe musht rrushi; Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese; Pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierje të pijeve të	3 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë dhe 4 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 gradë 10 000 lekë/HL për

	22 06 00 59 22 06 00 89	fermentuara dhe pijeve joalkoolike të pagazuara. - nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 10 000 hektolitër/vit - nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 10 000 hektolitër/vit	verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë dhe 12 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 gradë
W300 Vera spunante, Shampanja dhe pijet e fermentuara dhe të gazuara	22 04 10 22 04 21 06 22 04 21 07 22 04 21 08 22 04 21 09 22 05 10 10 22 05 90 10 22 06 00 39	Verërat spumante, Shampanja; Verë ndryshe nga ato të nënkreut 220410, në shishe me tapa “kërpudhë” që lidhet me mbërthyes apo tela; verë e ndërtuar ndryshe me një presion të pranueshëm në sajë të dyoksidit të karbonit. Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese të një force alkoolike ndaj volumit prej 18% apo më pak. Pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierjet e pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të gazuara.	5 200 lekë/HL
	22 06 00 31 22 06 00 51 22 06 00 81	Cider dhe cider dardhe me permbajtje alkooli 8,5%	3120 lekë/HL

<p>I000 Pijet alkoolike të ndërmjetme</p>	<p>22 04 21 85 22 04 21 86 22 04 21 87 22 04 21 88 22 04 21 89 22 04 21 90 22 04 21 91 22 04 21 93 22 04 21 94 22 04 21 95 22 04 21 96 22 04 21 97 22 04 21 98 22 04 29 85 22 04 29 86 22 04 29 87 22 04 29 88 22 04 29 89 22 04 29 90 22 04 29 91 22 04 29 93 22 04 29 94 22 04 29 95 22 04 29 96 22 04 29 97 22 04 29 98 22 05 10 10 22 05 10 90 22 05 90 10 22 05 90 90 22 06 00 10 22 06 00 39 22 06 00 59 22 06 00 89</p>	<p>Pijet alkoolike të ndërmjetme me një forcë alkooli mbi 15% volum por që nuk e kalon 22% volum; Sipas përcaktimeve të nenit 74 të ligjit.</p>	<p>5 200 lekë/HL</p>
<p>S200 Pije alkoolike (Spirituos Beverages).</p>	<p>22042192 22042193 22042194 22042195 22042196 22042197 22042198 22042992 22042993</p>	<p>Pije alkoolike; të përfituara nga distilimi i verës së rrushit apo të bërsive të rrushit, Whisky, Rum dhe të tjera pije të përfituara nga distilimi i produkteve të fermentuara nga kallami i sheqerit, Gin dhe Geneva, Vodka, likere dhe tonike, Uzo. - nga prodhues vendas e të huaj me sasi &lt; = 20 000 hektolitër/vit</p>	<p>65 000 lekë për HL alkool anhidër</p>

	22042994 22042995 22042996 22042997 22042998 22051090 22059090 22060010 22060039 22060059 22060089 22082012 22082014 22082026 22082027 22082029 22082040 22082062 22082064 22082086 22082087 22082089 22083011 22083019 22083030 22083041 22083049 22083061 22083069 22083071 22083079 22083082 22083088 22084011 22084031 22084039 22084051 22084091 22084099 22085011 22085019 22085091 22085099 22086011 22086019 22086091 22086099 22087010 22087090	- nga prodhues vendas e të huaj me sasi >20 000 hektolitër/vit	84 500 lekë për HL alkool anhidër
--	--	--	--------------------------------------

	22089011 22089019 22089033 22089038 22089041 22089045 22089048 22089052 22089054 22089056 22089069 22089071 22089075 22089077 22089078		
--	--	--	--

S300 Alkooli etilik jo i denatruar	22071000 22089091 22089099	Alkool etilik jo i denatruar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80% volum apo më shumë	45 000 lekë për HL alkool anhidër
S400 Alkool etilik i denatruar	22072000	Alkool etilik i denatruar	0 (zero)
S400 Rakia sipas përcaktimeve të nenit 66 të ligjit	22082029	Raki	20 000 lekë për HL alkool anhidër
S500 Produkte të tjera që përmbajnë alkool etilik	Kapitujt 17 deri 22 të NK	Të gjitha produktet që kanë një shkallë alkoolometrike efektive mbi 1,2 % ndaj volumit dhe pavarësisht klasifikimit në sistemin NK, sipas nenit 64 të ligjit	45 000 lekë për HL alkool anhidër
<b>III</b>		<b>DUHAN DHE NËNPRODUKTET E TIJ</b>	
T300 Puro dhe cigarillos	24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	4400 lekë/kg
T200 Cigare që përmbajnë duhan	24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan	5500 lekë/1000 copë Në 1 janar 2018 5750 lekë/1000 copë Në 1 janar 2019 6000 lekë/1000 copë Në 1 janar 2020 6250 lekë/1000 copë Në 1 janar 2021

			6500 lekë/1000 copë
T500 Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	4400 lekë/kg
T400 Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit	24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prej duhani  Duhan i përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri	4400 lekë/kg  2500 lekë/kg
<b>IV</b>		<b>PRODUKTET ENERGJETIKE</b>	
E200 Vajrat vegjetale dhe shtazore të klasifikuara në krerët 1507 deri	1507 deri 1518	Vajrat dhe dhjamërat prej kafshëve apo vegjetale dhe produktet prej tyre	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
1518 të NK nëse përdoren për ngrohje apo motorë			
E300 Vajra minerale	27071010 27071090 27072010 27072090 27073010 27073090 27075010 27075090	Produktet e vajrave minerale që i përkasin kodeve NK të kreut 2707	50 lekë/litri
E400	27 10 12 11	Naftë që kërkon një proces specifik përpunimi	50 lekë/litri
E410	27 10 12 41 27 19 12 45 27 10 12 49	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 95 oktan Me 95-98 oktan Me 98 e më shumë oktan	37 lekë/litri
E420	27 10 12 51 27 10 12 59	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 98 oktan Me 98 e më shumë oktan	50 lekë/litri

E430	27 10 19 11 deri 27 10 19 29 27 10 19 21 deri 27 10 19 25	Vajguret Karburantet, tip vajguri	20 lekë/litri 20 lekë/litri
E440	27 10 19 31 deri 27 10 19 48	Vajra të rënda (gazoil)	37 lekë/litri
E450	2710 19 51 deri 27 10 19 69	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	37 lekë/kg
E460	2710 20	Biodiesel me vajra nafte	37 lekë/kg
E470	27 10 19 71 deri 27 10 19 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/kg
E471	27109100 deri 27109900	Mbetje vajrash	5 lekë/kg
E472	27 12 10 90	Graso	40 lekë/kg
E480	2713 11 00 2713 12 00	Koks nafte	2 lekë/kg
E490	27 13 20 00	Bitum nafte	5 lekë/kg
E490	27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5 lekë/kg
E491	27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpentinën e katranit mineral (masticet bituminoze) Vernik Bituminoz (psh asfalto-beton)	5 lekë/kg bitum
E500 Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike	27111211 27111219 27111291 27111293 27111294 27111297 27111310 27111330 27111391 27111397 27111400	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim si lëndë djegëse për motor automjetesh.	8 lekë/litri

E501 Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike	27111211 27111219 27111291 27111293 27111294 27111297 27111310 27111330 27111391 27111397 27111400	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim të ndryshëm nga ai si lëndë djegëse për motor automjetesh.	0 lekë/litri
E600 Hidrokarburet aciklike	2901	Hidrokarburet aciklike	37 lekë/kg
E700 Hidrokarburet ciklike	2902	Hidrokarburet ciklike	37 lekë/kg
E800 Metanol (Alkooli metilik)	29051100	Metanol (Alkooli metilik)	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
L000	34 03 19 10 34 03 99 00	Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve	40 lekë/kg
L000 Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi; Alkibenzenet e përziera	3811 dhe 3817	Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi, stabilizator rrëshire, përmirësues viskoziteti, kundër korrozionit, dhe elemente shtesë të përgatitura për vajrat minerale (përfshirë benzinën) apo lëngje të tjera të përdorura për qëllime të tjera si vajrat minerale Alkibenzenet e përziera dhe Alkinaftalenet e përziera	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
E920 Biodiezel	3826 00	Acidet yndyrore /Biodiezel me më pak se 70% vajra nafte të kapitullit 27	37 lekë/litri
<b>V</b>		<b>FISHEKZJARRËT</b>	
F000 Fishekzjarrët	36 04 10 00	Fishekzjarrët	200 lekë/kg
F000	36 04 90 00	Të tjera	200 lekë/kg
<b>VI</b>		<b>GOMAT</b>	
P100 Goma të reja	40 11	Goma të reja pneumatike prej gome	20 lekë/kg
P200 Goma të riveshura	40 12 (përveç 40 12 20 00)	Goma pneumatike të riveshura; goma mishi apo të zakonshme; veshja e jashtme (pjesa me lule) dhe fashetat e gomës	40 lekë/kg



P300 Goma të përdorura	40 12 20 00	Goma pneumatike të përdorura	100 lekë/kg
<b>VII</b>		<b>PILAT DHE BATERITË PRIMARE; AKUMULATORËT ELEKTRIKË</b>	
A100 Pilat dhe bateritë primare	85 06	Pilat dhe bateritë primare	200 lekë/kg
A200 Akumulatorët	85 07	Akumulatorët elektrikë, përfshirë ndarëset e tyre, nëse janë apo jo drejtkëndëshe (përfshirë katrorët)	20 lekë/kg
<b>VIII</b>		<b>LLAMBA INKANDESHENTE</b>	
Y100 Llambat inkadeshente	85 39 22 10 85 39 22 90 85 39 29 92 85 39 29 98	Llambat reflektor Të tjera Më tepër se 100 V Jo më tepër se 100 V	100 lekë/copa 100 lekë/copa 100 lekë/copa 100 lekë/copa